



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 74

2003

Gusht

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.525, datë 1.8.2003	Për riorganizimin e ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve.....	3379
Vendim i KM nr.546, datë 1.8.2003	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondeve buxhetore, të planifikuara për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet”, i ndryshuar me vendimin nr.146, datë 7.3.2003.....	3380
Vendim i KM nr.555, datë 1.8.2003	Për mbylljen tërësore të disa minierave të hekurnikelit, bakrit, fosforiteve dhe kromit.....	3381
Vendim i KM nr.556, datë 1.8.2003	Për miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO” ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “TEODORI” sh.p.k.,Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë dhe në Zall të Bulqizës.....	3383
Vendim i KM nr.557, datë 1.8.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga rikonstruksioni i varrezave në Sharrë, Tiranë.....	3393
Vendim i KM nr.558, datë 1.8.2003	Për shpalljen e Voskopojës "Qendër historike" dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit.....	3395

Vendim i KM nr.559, datë 1.8.2003	Për një ndryshim në vendimin nr.96, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin, për vitin 2003, të numrit të punonjësve të institucioneve buxhetore" dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë.....	3397
Vendim i KM nr.560, datë 1.8.2003	Për disa shtesa në vendimin nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për strukturat dhe nivelet e pagave të nëpunësve civilë në institucionet e administratës qendrore, administratës së Presidentit dhe të Kuvendit" dhe për një ndryshim në vendimin nr.726, datë 21.12.2001 të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", i ndryshuar.....	3397
Vendim i KM nr.561, datë 1.8.2003	Për miratimin e planit të veprimit për heqjen e pengesave administrative në fushën e investimeve.....	3398
Vendim i KM nr.564, datë 7.8.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajjtshme, që preken nga rehabilitimi i urës së Bënçës, Tepelenë.....	3418
Vendim i KM nr.565, datë 7.8.2003	Për shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajjtshme, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë Mejdani-Qafë Morinë.....	3419

V E N D I M
Nr.525, datë 1.8.2003

PËR RIORGANIZIMIN E NDËRMARRJEVE TË TRAJTIMIT TË STUDENTËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 121 e 124 të Kodit të Procedurave Administrative, të pikës 1 të nenit 29 të ligjit nr.8379, datë 9.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë", të nenit 16 të ligjit nr.8939, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003" dhe të ligjit nr.7582, datë 13.7.1992 "Për ndërmarrjet shtetërore", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Riorganizimin, sipas juridiksionit territorial ku veprojnë, të qendrave studentore, si ndërmarrje me subvencione shtetërore, në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në funksion të trajtimit të studentëve, jashtë procesit mësimor, si më poshtë vijojnë:

- a) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.1, Tiranë (NTS 1);
- b) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.2, (NTS 2);
- c) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve nr.3, Tiranë (NTS 3);
- ç) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Shkodër (NTSSH);
- d) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Elbasan (NTSE);
- dh) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Korçë (NTSK);
- e) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Vlorë (NTSV);
- ë) Ndërmarrja e trajtimit të studentëve, Gjirokastrë (NTSGJ).

2. Drejtoria e Përgjithshme e Qendrave Studentore (DPQS), ndërmarrja e gjelbërimit të mjediseve studentore (NGJMS) dhe ndërmarrja e elektrik-ujësjellësit të mjediseve studentore (NEUMS), të shkrihen.

3. Mjediset e administruara nga strukturat e përmendura në pikën 2 të këtij vendimi, të kalojnë në administrim të ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve, sipas juridiksionit territorial të tyre, të cilat të realizojnë edhe funksionet e këtyre strukturave.

4. Drejtuesit e ndërmarrjeve të trajtimit të studentëve emërohen nga Ministri i Arsimit dhe i Shkencës.

5. Për punonjësit, që pas riorganizimit mbeten pa punë, të zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

6. Buxheti i mbetur i strukturave që shkrihen, të cilat kanë qenë në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, t'u kalojë përkatësisht, ndërmarrjeve që do t'i kenë në administrim. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2003, t'i shtohen fondet, për periudhën e mbetur të këtij viti, në zërat "Subvencion" dhe "Shpenzime kapitale", të cilat do t'i pakësohen buxhetit të vitit 2003, miratuar për Ministrinë e Ekonomisë, për ndërmarrjet e trajtimit të studentëve, sipas pikës 1, në përputhje me aktrakordin ndërmjet palëve.

7. Vendimi nr.214, datë 15.7.1991 i Këshillit të Ministrave "Për shkëputjen e veprimtarisë jetësore të studentëve nga drejtimi i shkollave të larta", i ndryshuar, vendimi nr.395, datë 12.8.1999 i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e qendrave studentore" dhe vendimi nr.145, datë 31.3.2000 i Këshillit të Ministrave "Për riorganizimin e qendrave studentore", shfuqizohen.

8. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

V E N D I M
Nr.546, datë 1.8.2003

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.675, DATË 20.12.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PËRDORIMIN E FONDEVE BUXHETORE, TË PLANIFIKUARA PËR MALLRAT, SHËRBIMET DHE NDËRTIMET”, I NDRYSHUAR ME VENDIMIN NR.146, DATË 7.3.2003

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me propozimin e Ministrit të Shtetit pranë Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin nr.675, datë 20.12.2002 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 1.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“1.2 Vendimi të zbatohet nga të gjitha entet prokuruese, që kanë fonde buxhetore të planifikuara për mallra, shërbime dhe ndërtime dhe nga organet e qeverisjes vendore, për fondet që jepen nga Buxheti i Shtetit për këtë qëllim.”.

2. Pika 1.3 të shfuqizohet.

3. Në pikën 2.1 fjala “... institucionet ...” zëvendësohet me “... entet prokuruese ...”.

4. Pika 2.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.2 Një kopje e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike, i miratuar nga drejtuesi i entit prokurues, i dërgohet brenda datës 20 janar të çdo viti, institucionit që vë në dispozicion fondet. Institucionet që vënë në dispozicion fondet, brenda datës 30 janar të çdo viti, dërgojnë në Agjencinë e Prokurimit Publik, në Drejtorinë e Thesarit dhe të Buxhetit në Ministrinë e Financave, përmbledhjen e regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike të tyre dhe të enteve të varësisë. Drejtoria e Thesarit dhe e Buxhetit u dërgon nga një kopje degëve të thesarit në rrethe.”.

5. Pika 2.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“2.3 Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve publike, të dërguara nga institucionet qendrore, përgatit regjistrin qendror të parashikimeve të prokurimeve publike dhe e shpall atë në “Buletin e Prokurimit Publik”, brenda datës 15 shkurt të çdo viti.”.

6. Pika 2.4 shfuqizohet.

7. Emërtimi i kapitullit III ndryshon dhe bëhet “Prokurimi i mallrave, shërbimeve dhe ndërtimeve”.

8. Pika 3.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“3.2 Procedurat e prokurimit për fonde të krijuara ose të shtuara pas miratimit të Buxhetit të Shtetit, nisin menjëherë pas vënies në dispozicion të këtyre fondeve. Në këtë rast, institucionet qendrore njoftojnë Drejtorinë e Thesarit dhe të Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Agjencinë e Prokurimit Publik, të cilat bëjnë ndryshimet në regjistrat përkatës”.

9. Pika 3.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“3.3 Procedurat e prokurimit për fonde të planifikuara për ndërtime, të cilat nuk kanë projekte të miratuara, nisin menjëherë, pas përfundimit të projektit.”.

10. Pika 4.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“4.3 Kontratat pas kryerjes së procedurave të prokurimit, të përcaktuara në pikat 6.1 dhe 6.2 të këtij vendimi, lidhen nga institucioni, në emër të të cilit është zhvilluar prokurimi, për fondin e vënë në dispozicion dhe sipas nevojave të parashikuara.”.

11. Në pikën 5.1 fjalët “... organet dhe institucionet buxhetore ...” zëvendësohen me “... entet prokuruese ...”. Pas fjalës “... prokurimeve ...” shtohet fjala “... publike...”.

12. Pika 5.2 ndryshon si më poshtë vijon:

“5.2 Një kopje e regjistrit të realizimeve të prokurimeve publike, i miratuar nga drejtuesi i entit prokurues, i dërgohet brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi, institucionit që vë në dispozicion fondet. Këto institucione dërgojnë në Agjencinë e

Prokurimit Publik, brenda 30 ditëve nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi, përmbledhjen e regjistrave të realizimeve të prokurimeve publike të tyre dhe të enteve të varësisë.”.

13. Pika 5.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“5.3 Agjencia e Prokurimit Publik, në bazë të të dhënave të regjistrave të realizimeve të prokurimeve publike, të dërguara nga institucionet qendrore dhe vendore, përgatit regjistrin qendror të realizimeve të prokurimeve publike dhe e shpall atë në “Buletinin e Prokurimit Publik”, brenda datës 31 korrik të çdo viti.”.

14. Pika 6.1 ndryshon si më poshtë vijon:

“6.1 Institucionet qendrore, brenda datës 10 janar të çdo viti, përcaktojnë listat e mallrave, të ndërtimeve ose të shërbimeve të njëjta të parashikuara nga entet e varësisë, për të cilat procedurat e prokurimit do të kryhen nga institucioni qendror ose nga institucioni i autorizuar prej tij. Ky ent prokuron me fondin e llogaritur si shumë e fondeve të miratuara, për çdo ent varësie, për të njëjtin mall, shërbim ose ndërtim.

Për mallrat, shërbimet dhe ndërtimet e tjera prokurimi të kryhet nga çdo ent prokurues i varësisë, në përputhje me procedurat e ligjit “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe të fondeve përkatëse në dispozicion.”.

15. Në paragrafin e parë të pikës 6.2 fjalët “... mallrat dhe shërbimet ...” zëvendësohen me “... mallrat, ndërtimet dhe shërbimet ...”.

16. Në paragrafin e katërt të pikës 6.2 hiqen fjalët “... telefoni celulare ...”.

17. Në paragrafin e gjashtë të pikës 6.2 fjalët “... autovetura të tjera...” zëvendësohen me “... autovetura të reja ...”.

18. Pika 6.3 ndryshon si më poshtë vijon:

“6.3 Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e pikës 6.2 të këtij vendimi, u dërgon institucioneve, enteve prokuruese, të ngarkuara për prokurimin e fondeve për llogari të të tretëve, të dhënat e regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike.”.

19. Në pikën 6.4 fjalët “... 15 shkurt ...” zëvendësohen me “... 31 janar ...”.

20. Pika 7.1 ndryshon si më poshtë vijon:

“7.1 Afati i përcaktuar në pikën 3.1 të këtij vendimi për vitin 2003 shtyhet deri në datën 30 tetor, duke përfshirë edhe të gjitha procedurat e prokurimit, të zhvilluara pas datës 15 qershor 2003.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

V E N D I M **Nr.555, datë 1.8.2003**

PËR MBYLLJEN TËRËSORE TË DISA MINIERAVE TË HEKURNIKELIT, BAKRIT, FOSFORITEVE DHE KROMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të mos vlerësohen pjesë të sektorëve me rëndësi të veçantë dhe t’u nënshtrohen procesit të mbylljes, privatizimit ose likuidimit minierat, si më poshtë vijojnë:

1.1 Miniera e hekurnikelit Radokal	Librazhd, Elbasan
1.2 Miniera e hekurnikelit Pishkashi Verior	Librazhd, Elbasan
1.3 Miniera e hekurnikelit Golem	Librazhd, Elbasan
1.4 Miniera e hekurnikelit Guri i Pishkashit	Librazhd, Elbasan
1.5 Miniera e hekurnikelit Çervenakë Perëndimore	Pogradec, Korçë

- | | |
|--|-----------------------|
| 1.6 Miniera e hekurnikelit Çervenakë Lindore | Pogradec, Korçë |
| 1.7 Miniera e nikelsilikatit Bitinckë
(pjesa e palicencuar) | Bilisht, Korçë |
| 1.8 Miniera e bakrit Kanisqel | Korçë |
| 1.9 Miniera e fosforiteve Fushë-Bardhë | Gjirokastër |
| 1.10 Miniera e fosforiteve Gusmar | Tepelenë, Gjirokastër |
| 1.11 Vendburimi i kromit Kodra e Lerës | Bulqizë, Dibër |
| 1.12 Traverbangët e NNMinierës Bulqizë
Qafë-Lamë | Bulqizë, Dibër |
| 1.13 Traverbangu Lucanë, thellësi, Batër | Bulqizë, Dibër |
| 1.14 Rampa Qafë-Buall | Bulqizë, Dibër |
| 1.15 Vendburim Qafë-Buall | Bulqizë, Dibër |
| 1.16 Barta Jugore thellësi e sipërfaqe, Batër | Bulqizë, Dibër |
2. Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës brenda muajit gusht 2003, të fillojë procedurat e hartimit të projekteve dhe të bëjë preventivat e mbylljes së minierave të përmendura në pikën 1, ndërsa mbyllja e tyre të realizohet gjatë vitit 2004.
3. Makineritë, pajisjet, materialet dhe objektet sipërfaqësore të privatizohen, në përputhje me legjislacionin në fuqi ose të transferohen për t'u përdorur për nevoja të organeve të pushtetit vendor.
4. Fondet që nevojiten për mbylljen e këtyre minierave, të përballohen nga fondet buxhetore për mbylljen dhe konservimin e objekteve minerare të Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës.
5. Punonjësit, të cilët deri më 1.1.2003 kanë qenë në marrëdhënie pune dhe do të jenë të tillë deri në çastin e mbylljes së minierave, të trajtohen për 1(një) vit me pagën minimale në shkallë vendi.
6. Periudha 1-vjeçare të njihet si vjetërsi pune, për efekt pensioni dhe të shënohet e tillë në librezën e punës.
7. Të drejtën e trajtimit sipas këtij vendimi, e kanë ata punonjës, që nuk zhvillojnë veprimtari ekonomike në fushën e punësimit ose të vetëpunësimit. Në rast të kundërt, u ndërpritet trajtimi që përfitojnë sipas këtij vendimi.
8. Pagesa e punonjësve, që dalin të papunë nga zbatimi i këtij vendimi, si dhe e kontributeve për sigurimet shoqërore të bëhet nga zyrat e punës në rrethet përkatëse. Fondet e nevojshme për këtë qëllim, për vitin 2004, të programohen nga Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale.
9. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimit përkatës në zbatim të tij.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

V E N D I M

Nr.556, datë 1.8.2003

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOO” NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIËS DHE TË ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “TEODORI” SH.P.K. TIRANË, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALEVE NË TËRNOVË DHE NË ZALL TË BULQIZËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 7 e 9 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbime publike dhe në infrastrukturë”, i ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e Marrëveshjes së koncesionit të formës “BOO” ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës dhe shoqërisë “Teodori” sh.p.k., Tiranë, për ndërtimin e hidrocentraleve në Tërnovë dhe në Zall të Bulqizës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
FATOS NANO

MARRËVESHJE

KONCESIONI PËR NDËRTIMIN, PRONËSINË DHE SHFRYTËZIMIN E HIDROCENTRALEVE VENDORE TËRNOVË DHE ZALLI I BULQIZËS, ME KONCESION TË FORMËS BOO (NDËRTIM, PRONËSI, SHFRYTËZIM)

Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, si “Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA)”, i përcaktuar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.32, datë 16.1.2003, që më poshtë do të quhet i tillë dhe shoqërisë “Teodori”, sh.p.k., Tiranë, regjistruar si person juridik me vendimin nr.21820, datë 17.8.1999 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që më poshtë do të quhet “Koncesionari”.

HYRJJE

Duke pasur parasysh që Qeveria shqiptare:

konsideron privatizimin e sektorit elektroenergjetik si një element të rëndësishëm të politikës elektroenergjetike;

është e angazhuar për ngritjen dhe zhvillimin e tregut të energjisë elektrike brenda vendit;

mirëpret investitorët vendas në ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike;

vlerëson formulën e koncesionit BOO, që bën të mundur ndërtimin e hidrocentraleve vendore pa prekur Buxhetin e Shtetit;

autorizon, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.32, datë 16.1.2003 “Për miratimin e propozimit si projekt i pakërkuar i kërkesës për ndërtimin e hidrocentraleve Tërnovë dhe Zalli i Bulqizës, me koncesion të formës BOO”, Ministrinë e Industrisë dhe të Energjetikës të negociojë dhe të nënshkruajë Marrëveshjen e koncesionit.

Koncesionari:

- është seriozisht i interesuar të investojë në fushën e elektroenergjetikës;

- ka ndërmarrë studimin tekniko-ekonomik për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve, objekte të këtij koncesioni.

Palët:

- bien dakord që të bashkëpunojnë për ndërtimin e hidrocentraleve Tërnovë dhe Zalli i Bulqizës, me koncesion të formës BOO, që më poshtë do të cilësohen “Hidrocentrale”.

Neni 1

Përkufizime

Kudo që në këtë kontratë përdoren termat e mëposhtëm, ato do të kenë kuptimet përkatëse të mëposhtme:

Marrëveshja e koncesionit: ky dokument dhe anekset e tij.

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës.

Koncesionari: shoqëria “TEODORI” sh.p.k., Tiranë.

Hidrocentralet: Përcaktohen në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.32, datë 16.1.2003 "Për miratimin e propozimit si projekt i pakërkuar i kërkesës për ndërtimin e hidrocentraleve Tërnovë dhe Zalli i Bulqizës, me koncesion të formës BOO".

Periudhë koncesioni: Periudha kohore deri në marrjen në pronësi të hidrocentraleve nga Koncesionari.

Projekti: Studimi tekniko-ekonomik për ndërtimin e hidrocentraleve vendore, Tërnovë dhe Zalli i Bulqizës, me koncesion të formës BOO.

Kontratat: Të gjitha kontratat që mund të përfundohen nga Koncesionari, në të ardhmen, për realizimin e projektit.

Ndryshimi i ligjit: Do të thotë çdo akt që ka karakter rregullator ose ligjor të miratuar nga autoritetet kompetente të Republikës së Shqipërisë ose që ka hyrë në fuqi pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Lejet: Lejet, licencat, autorizimet dhe koncesionet që Koncesionari mund t'u kërkojë autoriteteve kompetente në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin e plotë të projektit, si dhe për stafin e vet, në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Fillimi i punimeve: Periudha gjashtëmujore pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Neni 2

Objekti i koncesionit

Marrëveshja aktuale e koncesionit shërben për të rregulluar koncesionin që Organi Shtetëror i Autorizuar prej Këshillit të Ministrave i ka dhënë Koncesionarit në bazë të termave dhe kushteve të artikuluar në nenet e kësaj Marrëveshjeje për ndërtimin, pronësinë dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve.

Objekt i koncesionit është të përfundojë ndërtimin e hidrocentraleve, të përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.32, datë 16.1.2003.

Neni 3

Karakteristikat e hidrocentraleve

Karakteristikat kryesore të centraleve janë:

Për liqenet e Tërnovës:

H/C	Nr.1	Q =0.2 m3/sek	H = 150 m	N = 2x 300 = 600 kW
H/C	Nr.2	Q =0.2 m3/sek	H = 100 m	N = 2x 200 = 400 kW
H/C	Nr.3	Q =0.2 m3/sek	H = 100 m	N = 2x 200 = 400 kW
H/C	Nr.4	Q =0.2 m3/sek	H = 100 m	N = 2x 200 = 400 kW
H/C	Nr.5	Q =0.2 m3/sek	H = 150 m	N = 2x 300 = 600 kW
H/C	Nr.6	Q =0.2 m3/sek	H = 300 m	N = 2x 500 = 600 kW

E= 15.5 GWh

Për Zallin e Bulqizës:

H/C Nr.1 Q = 2m3/sek; H = 104 m N=2x1000 = 2000 kW;
E=13.2 GWh

Neni 4

Detyrimet e Koncesionarit

Koncesionari është i detyruar të zbatojë projektin dhe objektin e Marrëveshjes konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Koncesionari angazhohet që:

- Të ndërtojë hidrocentralet duke siguruar vetëfinancimin e tyre, sipas anekseve që i bashkëlidhen kësaj Marrëveshjeje.

- Të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionet e nevojshme për projektin që do të zbatojë.

- Të projektojnë hidrocentralet konform standardeve të përparuara europiane.
- Të mos pengojë OSHA-në të ushtrojë të drejtën e kontrollit mbi të sipas ligjit.
- Brenda 30 ditëve nga nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, Koncesionari do të formojë shoqërinë koncesionare sipas ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe në infrastrukturë".
- Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
- Të marrë masa, me qëllim që çdo investim të jetë sipas afateve në këtë Marrëveshje dhe me cilësinë e kërkuar.
- Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen palëve të treta.
- Të mbajë të informuar OSHA-në për çdo rrethanë, që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit.
- Të ndjekë dhe të zbatojë të gjitha dispozitat ligjore për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe për marrëdhëniet e punës.
- Në veprimtarinë e tij të respektojë legjislacionin shqiptar në fuqi, në veçanti për fushën ku vepron, të respektojë ligjin "Për sektorin e energjisë elektrike".
- Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë kushte teknike për punëtorët dhe për të tretët, për të shmangur dëmet ndaj pronës publike dhe private dhe të respektojë legjislacionin në fuqi, si dhe dispozitat e tjera për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
- Të realizojë kontrata të përshtatshme sigurimi për të mbuluar çdo risk të mundshëm.
- Të marrë përsipër zgjidhjen e çdo problemi, që lidhet me pretendimet e personave fizikë dhe juridikë të ndryshëm për pronësinë e truallit nën objektet e dhëna me koncesion.
- Të zgjidhë problemin e përdorimit të ujit pranë Komitetit Kombëtar të Ujërave, në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- Të mos prekë regjimin e ujitjes gjatë sezonit, si dhe të nënveprave që shërbejnë për marrjen e ujit nga kanalet ujitëse, gjatë rikonstruksionit të tyre nga Koncesionari.

- Të përjashtojë çdo lloj përgjegjësie të OSHA-së, për sa parashikohet në këtë nen, për dëmet, dëmtimet dhe të tjera që mund t'i ndodhin Koncesionarit dhe punonjësve të tij gjatë periudhës së koncesionit.

Neni 5

Detyrimet e OSHA-së

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

- Të asistojë Koncesionarin për aplikimet, marrëveshjet ose kontratat e nevojshme për zbatimin e projektit, me institucionet e tjera si ERE, KKUjërave, KESH.
- Të ndihmojë Koncesionarin në finalizimin e një Marrëveshjeje afatgjatë me KESH sh.a., për shitjen e energjisë elektrike, për aq kohë sa KESH sh.a. të jetë me kapital tërësisht shtetëror.
- Të ndihmojë Koncesionarin pranë KESH-it ose pranë institucioneve të ngarkuara për marrjen e lejes së nevojshme për lidhjen me sistemin elektroenergjetik dhe transmetimin e energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet.

Neni 6

Vlerësimi i investimeve

Mbi bazën e të dhënave të disponueshme deri tani, investimet e nevojshme për objektin e kësaj kontrate janë vlerësuar rreth 3.44 milionë euro (anekset 1-7 bashkëlidhur).

Koncesionari do t'i paraqesë OSHA-së faturat e blerjeve, sipas ligjeve shqiptare, për të justifikuar vlerat e investuara.

Vlerësimi i mësipërm mund të pësojë ndryshime pas përfundimit të projektit të zbatimit.

Neni 7

Shitja e energjisë elektrike të prodhuar

Sipas çmimit të shitjes së energjisë elektrike të aprovuar nga ERE (Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike), KESH sh.a. është i autorizuar të firmosë me Koncesionarin një marrëveshje për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar, për një afat të rënë dakord ndërmjet Palëve.

Neni 8

Programi i punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin e mëposhtëm:

1. Koncesionari merr përsipër të përfundojë projektin e zbatimit brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës.
2. Koncesionari merr përsipër të fillojë punën brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës.
3. Koncesionari merr përsipër të përfundojë këtë investim brenda 30 (tridhjetë) muajve të hyrjes në fuqi të kontratës.
4. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

Neni 9

Periudha e koncesionit

Në përputhje me këtë Marrëveshje koncesioni, OSHA i jep Koncesionarit të drejtën e ndërtimit të hidrocentraleve dhe pas përfundimit të punimeve dhe vënies në punë të objekteve, që shprehet nëpërmjet paraqitjes së një raporti të hollësishëm të përcaktuar nga të dyja Palët, Koncesionari bëhet zotëruar i plotë i tyre dhe gëzon të drejtën e pronësisë dhe të shfrytëzimit të hidrocentraleve duke respektuar ligjin nr.8518, datë 30.7.1999 "Për ujëtimin e kullimin", si dhe të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.

Neni 10

Zgjidhja e Marrëveshjes së koncesionit

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) ka të drejtë të kërkojë prishjen e Marrëveshjes së koncesionit në mënyrë të njëanëshme, për rastet kur konstaton shkelje të vazhdueshme dhe të rënda të obligimeve të marrësit të koncesionit, në këtë Marrëveshje, të cilat kompromentojnë grafikun e investimit, cilësinë e punimeve dhe kushtet e tjera themelore të Marrëveshjes.

Kur nga ana e OSHA-së, provohet shkelja e ndonjë prej pikave 1, 2 dhe 3 të përmendura në nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje, ai menjëherë ia bën të njohur këtë shkelje Koncesionarit dhe është i detyruar të presë për një periudhë 30 ditore përgjigjen e tij, me argumentet përkatëse.

Mbi bazën e përgjigjeve, arsyetoni për të filluar ose jo procedurën për prishjen e Marrëveshjes.

Në rast se Marrëveshja e koncesionit prishet, investimet e bëra nga Koncesionari deri në momentin e heqjes së koncesionit, do të mbeten pronë e OSHA-së.

Neni 11

Kufizimi i koncesionit

Koncesionarit nuk i lejohet të transferojë asnjë pjesë të koncesionit, të marrë në bazë të kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Neni 12

Kontratat

Me qëllim që të realizohet objekti i koncesionit, Koncesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje.

Në të gjitha kontratat e sipërmarrjes, Koncesionari angazhohet të respektojë dispozitat e kësaj

Marrëveshjeje koncesioni.

Pavarësisht nga kontratat e sipërmarrjes, përgjegjës para OSHA-së për zbatimin e rregullt të kontratave të sipërmarrjes mbetet gjithmonë Koncesionari.

Me përjashtim të të drejtave dhe detyrave që i jepen OSHA-së në këtë kontratë, OSHA nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim kundrejt të tretëve.

Neni 13

Sigurimet

Objektet ku kryhen investimet, gjatë gjithë periudhës së koncesionit, sigurohen nga Koncesionari.

Koncesionari do t'i japë OSHA-së, me kërkesën e këtij të fundit, të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të gjitha llojet e sigurimeve.

Në rast se një objekt i siguruar do të dëmtohet dhe është i mbuluar nga sigurimet, të ardhurat nga siguracioni do të përdoren nga Koncesionari për riparimin e objektit.

Neni 14

Kontrolli

OSHA ruan të gjitha të drejtat kontrolluese mbi Koncesionarin gjatë gjithë periudhës së koncesionit.

OSHA, nëpërmjet të autorizuarëve të tij, mund të ushtrojë kontroll, me synim verifikimin e ecurisë së punimeve, në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit të projekteve të koncesionit në marrëveshje të përbashkët ndërmjet Koncesionarit dhe OSHA-së.

Në rast të shkeljeve të Marrëveshjes, konstatuar gjatë kontrollit të përgjithshëm, Koncesionari do të njoftohet me shkrim dhe do të vërë në zbatim masat e nevojshme për të ardhmen.

Neni 15

Legjislacioni i zbatueshëm

Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje koncesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi, në momentin e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Forca madhore dhe të paparashikuara

Konsiderohen ngjarje të forcës madhore katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, ngjarjet e jashtëzakonshme politike, si lufta dhe ndërhyrja e palëve të treta që kanë fuqinë e ligjit, duke bërë të pamundur përmbytjen e detyrimeve reciproke të kontratës, që kanë të bëjnë me vullnetin e Palëve.

Gjatë zbatimit të kontratës, në rast se verifikohen ngjarje të forcës madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektime të detyrimeve të Palëve, ato nuk mund të jenë motive për kërkesa reciproke për zhdëmtim.

Në këtë rast, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

Kufijtë e ndërprerjes së punës dhe të shtyrjes në kohë të punimeve, do të konfirmohen nga Palët në një procesverbal të ngjarjes.

Neni 17

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së koncesionit

Marrëveshja e koncesionit do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me ligjin nr.7973, datë

26.7.1995 "Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike".

Neni 18

Klauzola të përgjithshme

Kjo Marrëveshje është hartuar në 7 (shtatë) kopje origjinale, 5 (pesë) prej të cilave do të merren nga Organi Shtetëror i Autorizuar dhe 2 (dy) kopje do të merren nga Koncesionari.

Neni 19

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Problemet ose mosmarrëveshjet ndërmjet Palëve, që kanë lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Marrëveshjeje koncesioni, nuk do të anulojnë detyrimet e Palëve sipas kësaj Marrëveshjeje.

Palët janë të angazhuara të zgjidhin çdo mosmarrëveshje me mirëkuptim, në të kundërt, çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Marrëveshje koncesioni, do të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit, Tiranë.

Neni 20

Sanksionet

Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Marrëveshjeje penalizojnë Palët me vendim të gjykatës së mësipërme.

Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 8, Koncesionari do t'i paguajë OSHA-së për çdo ditë vonesë penalitetin 0.01% të vlerës së investimit.

Neni 21

Bashkëpunimi ndërmjet OSHA-së dhe Koncesionarit

Organi Shtetëror i Autorizuar dhe Koncesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë implementimin e projektit. Përveç rasteve kur bien dakord me shkrim për ndonjë formë tjetër, korrespondenca do të dërgohet me letër me postë, telegram ose fax, në adresat e mëposhtme:

Organi Shtetëror i Autorizuar
OSHA
Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës
Sheshi "Skënderbej", nr.2, Tiranë

Koncesionari
Shoqëria "Teodori" sh.p.k.
Rruga "Niko Avrami"; Pallati 15, Hyrja
5. Ap.18, Tiranë

Aneksi Nr.1

Preventiv
HEC Nr.1 (Tërnovë)

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për kanalet e ushqimit	M3	1000	360	360 000
2	Gërmim për pastrim kanalesh	M3	200	240	48 000
3	Beton m200 për veshjen e ushqyesave t=8cm	M3	100	12 000	1 200 000
4	Beton m200 për veshjen e kanalit përcjellës	M3	50	10 800	540 000
5	Material për ndërtim dige	M3	1000	1056	
6	Konstruksione metalike	Ton	10	240 000	2 400 000
7	Fv tub çeliku	Ton	70	192 000	13 440 000
8	Godinë hec-i	M2	60	18 000	1 080 000
9	Kabinë me thika e transformatorë	Copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				23 124 000
	Rezervë ~ 5%				1156 000
	Totali				24 280 000

b. Makineri e pajisje

Hidroturbinë Pelton tipi HHP V5 me pajisjet elektrike, si dhe montimin, projektimin dhe kryerjen e provave

Copë 2 → 261 576 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë, vlera 36 620 640 lekë

Vlera totale:

24 280 000 + 36 620 640 = 60 900 640 lekë

Aneksi nr. 2

Preventiv

HEC Nr.2 (Tërnovë)

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për kanalet e ushqimit	m3	1000	360	360 000
2	Gërmim për pastrim kanalesh	m3	1000	240	240 000
3	Beton M200 për veshje e ushqyesave	m3	100	12 000	1 200 000
4	Beton M200 për veshje të kanalit përcjellës	m3	200	10 800	2 160 000
5	Material për ndërtim dige	m3	1000	1056	1 056 000
6	FV Tub çeliku	ton	30	192 000	5 760 000
7	Godinë HEC-i	ton	60	18 000	1 080 000
8	Kabinë me thika e transformatorë	copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				14 856 000
	Rezervë ~ 5%				744 000
	Totali				15 600 000

b. Makineri e pajisje

Hidroturbinë Pelton tipi HHF V5 me pajisjet elektrike, si dhe montimin, projektimin dhe kryerjen e provave.

Copë 2 Vlera → 233 496 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë, vlera 32 689 440 lekë

Vlera totale:

15 600 000 + 32 689 000 = 48 289 440 lekë

ANEKSI NR. 3

Preventiv

HEC Nr.3 (Tërnovë)

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për kanalet e ushqimit	m3	1000	360	360 000
2	Gërmim për pastrim kanalesh	m3	800	240	192 000
3	Beton M200 për veshje e ushqyesave	m3	100	12 000	1 200 000
4	Beton M200 për veshje të kanalit përcjellës	m3	150	10 800	1 620 000
5	Material për ndërtim dige	m3	1000	1056	1 056 000
6	FV Tub çeliku	ton	50	192 000	9 600 000
7	Godine HEC-i	m2	60	18 000	1 080 000
8	Kabinë me thika e transformatorë	copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				18 108 000
	Rezervë ~ 5%				8 92 000
	Totali				19 000 000

b. Makinieri e pajisje

Hidroturbinë Pelton tip HHP V5 bashkë me pajisjet elektrike, si dhe montimin, projektimin dhe kryerjen e provave:

Vlera → 261 576 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë, vlera → 36 620 640 lekë

Vlera totale:

19 000 000 + 36 620 640 = 55 620 640 lekë

ANEKSI NR. 4

Preventiv

HEC nr.4 (Tërnovë)

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për kanalet e ushqimit	m3	1000	360	360 000
2	Gërmim për pastrim kanalesh	m3	600	240	144 000
3	Beton M200 për veshje të ushqyesave	m3	100	12 000	1 200 000
4	Beton M200 për veshje të kanalit përcjellës	m3	80	10 800	864 000
5	Material për ndërtim dige	m3	700	1056	739 200
6	Godine HEC-i	m2	60	18 000	1 080 000
7	Kabinë me thika e transformatorë	copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				7 387 000
	Rezervë ~ 5%				369 300
	Totali				7 757 500

b. Makineri e pajisje

Hidroturbinë Pelton Tip HHP V5 me pajisjet elektrike, si dhe montimin, projektimin dhe kryerjen e provave:

Vlera → 233 496 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë, vlera → 32 689 440 lekë

Vlera totale:

7 757 500 + 32 689 440 = 40 446 940 lekë

Aneksi nr. 5
Preventiv
HEC nr.5 (Tërnovë)

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për kanalet e ushqimit	m3	1000	360	360 000
2	Gërmim për pastrim kanalesh	m3	700	240	168 000
3	Beton M200 për veshje e ushqyesave	m3	100	12 000	1 200 000
4	Beton M200 për veshje të kanalit përcjellës	m3	150	10 800	1 620 000
5	Material për ndërtim dige	m3	1000	1056	1 056 000
6	Godinë HEC-i	m2	60	18 000	1 080 000
7	Kabinë me thika e transformatorë	copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				8 484 000
	Rezervë ~ 5%				424 300
	Totali				8 908 000

b. Makineri e pajisje

Hidroturbinë Pelton tipi HHP V5 me pajisjet elektrike, si dhe montimin, projektimin dhe kryerjen e provave:

Vlera - 261 576 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë, vlera → 36 620 640 lekë

Vlera totale:

8 908 000 + 36 620 640 = 45 528 640 lekë

ANEKSI NR. 6

Preventiv
HEC nr.6 (Tërnovë)

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për kanalet e ushqimit	m3	1000	360	360 000
2	Gërmim për pastrim kanalesh	m3	700	240	168 000
3	Beton M200 për veshje të ushqyesave	m3	150	12 000	1 800 000
4	Beton M200 për veshje të kanalit përcjellës	m3	170	10 800	1 836 000
5	Material për ndërtim dige	m3	1000	1056	1 056 000
6	Godinë HEC-i	m2	60	18 000	1 080 000
7	Kabinë me thika e transformatorë	copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				9 300 000
	Rezervë ~ 5%				465 300
	Totali				9 765 000

b. Makineri e pajisje

Hidroturbinë Pelton tipi HHO V5 me pajisjet elektrike, si dhe montimin, projektimin dhe kryerjen e provave:

Vlera - 320 868 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë, vlera → 44 921 520 lekë

Vlera totale:

9 765 000 + 44 921 520 = 54 686 520 lekë

ANEKSI NR. 7

Preventiv i HEC-it të Zallit të Bulqizës

a. Punime ndërtimi

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	Gërmim për riseksionim e pastrim	m3	30 000	300	9 000 000
2	Mur guri M.ç. M50	m3	1200	5000	6 000 000
3	Suvatim me llaç mbi mur guri	m2	4200	840	3 528 000
4	Soletë b/a për mbulim kanali	m3	210	12 000	2 520 000
5	Beton M150 për brez e riparim shtesë	m3	225	9600	2 160 000
6	Beton M 200 për veshje kanali	m3	3400	9600	32 640 000
7	Lugje b/a L= 10 m	copë	10	360 000	3 600 000
8	Vepër marrje	copë	1	1 320 000	1 320 000
9	F.V.Tub çeliku ø 800 L=360m	ton	50	192 000	9 600 000
10	Godinë HEC	m2	130	24 000	3 120 000
11	Kabinë me thika e transformatorë	copë	1	3 000 000	3 000 000
	Shuma				76 488 000
	Rezervë ~ 5%				3 812 000
	Totali				80 300 000

b. Makineri e pajisje

Hidroturbina Francis tipi 66-600 (komplet me pajisjet elektrike), si dhe me montimin, projektimin dhe kryerjen e provave:

Copë 2 → 685 454 euro

Për kursin 1 euro = 140 lekë → vlera - 95 963 560 lekë

Vlera totale:

80 300 000 + 95 963 560 = 176 263 560 lekë

V E N D I M Nr.557, datë 1.8.2003

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË PREKEN NGA RIKONSTRUKSIONI I VARREZAVE NË SHARRË, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

- Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme të pronarëve, të cilët preken nga rikonstruksioni i varrezave publike në Sharrë, Tiranë.
- Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Tiranës.
- Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës që paraqitet në listën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen prej 880 m2, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 1 760 000 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh.
- Ky fond të përballohet nga buxheti i vitit 2003, zëri "Shërbime publike", miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.
- Vlera e shpenzimeve procedurale, në shumën prej 147 500 (njëqind e dyzet e shtatë mijë e

pesëqind) lekësh të përballohet nga Bashkia e Tiranës, e cila do të kryejë edhe pagesën e pronarëve të shpronësuar.

6. Shpronësimi të fillojë dhe të përfundojë në periudhën 1-15 gusht 2003.

7. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**LISTA E PRONARËVE QË PREKEN NGA SHPRONËSIMI PËR INTERES PUBLIK PËR
RIKONSTRUKSIONIN E VARREZAVE TË SHARRËS, TIRANË**

Nr.	Emër, mbiemri	Sip.toke m/2	Njësia lekë m/2	Vlera lekë
	Pronarë në bashkëpronësi	805	2000	1 610 000
1	Qamile Hoxha (Muça)			
2	Sanie Kodra (Muça)			
3	Fiqirete Shima (Muça)			
4	Mude Bakalli (Muça)			
	Pronarë në bashkëpronësi	75	2000	150 000
1	Ike Muça			
2	Sofije Muça			
3	Xhelal Muça			
4	Sanije Muça			
5	Ramiz Muça			
6	Asllan Muça			
7	Qanije Muça			
8	Bedri Muça			
9	Nexhmije Karaj			
10	Suzana Xhepa			
11	Bujar Muça			
12	Agron Muça			
13	Arben Muça			
				1 760 000

V E N D I M
Nr.558, datë 1.8.2003

**PËR SHPALLJEN E VOSKOPOJËS "QENDËR HISTORIKE" DHE VËNIEN E SAJ NË
MBROJTJE TË SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 pika 23 dhe 31 pika 1 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", me propozimin e Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e Voskopojës "Qendër historike" dhe vënien e saj në mbrojtje të shtetit, sipas hartës, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, të hartojnë rregulloren e administrimit dhe të menaxhimit të kësaj zone, në përputhje me mastërplanin e miratuar nga KRRTRSH-ja, si zonë me përparësi për zhvillimin e turizmit, si dhe projektet për mbrojtjen, ruajtjen dhe restaurimin e elementeve përbërëse të kësaj qendre historike.

3. Ngarkohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe e Decentralizimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano



V E N D I M
Nr.559, datë 1.8.2003

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.96, DATË 13.2.2003 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE "PËR PËRCAKTIMIN, PËR VITIN 2003, TË NUMRIT TË PUNONJËSVE TË
INSTITUCIONEVE BUXHETORE" DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E
VITIT 2003, MIRATUAR PËR MINISTRINË E EKONOMISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 dhe 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të nenit 8 të ligjit nr.8983, datë 20.12.2002 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2003", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Numri i punonjësve të Ministrisë së Ekonomisë, i përcaktuar në pikën 7 të listës, që i bashkëlidhet vendimit nr.96, datë 13.2.2003 të Këshillit të Ministrave, duke filluar nga data 1 gusht 2003, bëhet 195.
 2. Ministrisë së Ekonomisë në buxhetin e miratuar për vitin 2003, në zërin "Shpenzime korrente", t'i shtohet fondi prej 1 000 000 (një milion) lekësh.
 3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.
